



VENDIM

I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë, sot më datë 2.7.2012, unë Asim Vokshi, Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga organizata “Shoqata e Kineastëve Shqiptarë”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Ndriçim Xhepa,

K O N S T A T O V A S E:

Me vendimin nr.1153 datë 22.10.2004 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë është bërë regjistrimi i organizatës jofitimprurëse të quajtur “Shoqata e Kineastëve Shqiptarë”.

Me Vendimin datë 12.04.2012 të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve është vendosur që në Statutin e Shoqatës të bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i katërt i nenit 8 të Statutit ndryshohet: “Mbledhja e përgjithshme zgjedh ose shkarkon Këshillin Drejtues dhe kryetarin e Këshillit Drejtues me votim të fshehtë”.
- Paragrafi i dytë i nenit 9 të Statutit ndryshohet: “Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, njeri prej të cilëve zgjidhet me cilësinë e Kryetarit nga Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës. Mandati i Kryetarit përfundon me përfundimin e mandatit të tij si anëtar i Këshillit Drejtues. Mbledhjet e Këshillit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve”.
- Paragrafi i parë i nenit 10 të Statutit ndryshohet: “Kryetari i Këshillit Drejtues që është njëkohësisht edhe Kryetar i Shoqatës zgjidhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve të shoqatës dhe ka këto kompetenca:”

Po me këtë vendim janë pranuar edhe disa anëtarë të rinj në shoqatë.

Gjithashtu, me vendim të datës 12.04.2012 Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve të Shoqatës ka zgjedhur si anëtarë të Këshillit Drejtues të Shoqatës, me mandat dy vjeçar shtetasit Ndriçim Xhepa, Gjergj Xhuvani, Kristaq Mitro, Anila Varfi, Durim Neziri. Njëkohësisht si Kryetar i Këshillit Drejtues dhe njëkohësisht edhe Kryetar i Shoqatës, me mandat dy vjeçar zgjidhet Ndriçim Xhepa.

Kërkesa e bërë dhe dokumentat e paraqitura janë konform ligjit dhe,

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të ligjit nr.8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe ligjit nr.8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave jofitimprurëse”

V E N D O S A :

Depozitimim në Regjistrin e Organizatave jofitimprurëse të Vendimeve datë 12.04.2012 të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve të organizatës “Shoqata e Kineastëve Shqiptarë”, me të cilat është vendosur:

1. Ndryshimi i disa dispozitave të Statutit të Shoqatës.
2. Pranimi i anëtarëve të rinj në Shoqatë.
3. Zgjedhja si anëtarë të Këshillit Drejtues të Shoqatës, me mandat dy vjeçar e shtetasve Ndriçim Xhepa, Gjergj Xhuvani, Kristaq Mitro, Anila Varfi, Durim Neziri.
4. Zgjedhja e z.Ndriçim Xhepa si Kryetar i Këshillit Drejtues dhe njëkohësisht edhe Kryetar i Shoqatës, me mandat dy vjeçar.

Regjistrimin e ndryshimeve të mësipërme në Regjistrin përkatës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTAR
ASIM VOKSHI